

Përdorni më mirë potencialin e lopëve



Sipas një studimi të kryer në qendrën kërkimore Hülsenberg të Schaumann për fermat e lopëve qumështore me rendimete të larta, rezultoi se ato janë shumë të sukseshme, sepse aplikojnë strategji holistike.

A ja vlen të shfrytëzojmë potencialin e lopëve apo me performancën e tyre në rritje do hasim në të njëjtën kohë dhe më shumë probleme? A është ndoshta më e favorshme të mjelim më pak qumësht? Këto janë shpesh çështje të rëndësishme në fermat e qumështit. Si mund arrihet që një fermë të ketë performancë të lartë, por pa pasur rritje të kostove?


Problem – Vlerat mesatare

Në shumë ferma të prodhimit të qumështit punohet me vlerat mesatare, të tilla si konsumi i ushqimit mbi lëndën e thate prodhimit të qumështit në mesataren e tufës, parametrat e fertilitetit, e numërimit të qelizave somatike, të kostos së ushqimit dhe cilësisë së ushqimit. Në shumë raste, kjo do të jetë e rëndësishme për të reduktuar "pasojat negative".

Për të shfrytëzuar më mirë potencialin, do të thotë jo vetëm një rritje e performancës, por edhe një optimizim i faktorëve të ndryshëm, të tillë si shëndeti i gjirit, pjelloria, performanca bazë në ushqim, efikasiteti në ushqim apo uljen e kostove veterinarë. Efikasiteti i ushqimit ndikon në konvertimin e ushqimit për kg qumësht dhe në këtë mënyrë koston e ushqimit për kg qumësht. Nëse, për shembull, vendosni të rrisni prodhimin e qumështit, nuk duhet të llogariten shpenzimet mesatare të ushqimit, por kostot marginale.


Pyetja është: Cila është kostoja e një litri shtesë qumësht? Performanca më e lartë e qumështit lidhet kryesisht me një rritje në pikun e laktacionit, apo duke këmbëngulur më shumë?

Në Hülsberg janë mjelur për shumë vite më shumë se 10.000 kg qumësht dhe zakonisht më shumë se 11.000 kg qumësht (grafiku 1). Krahasuar me vitin 2008, prodhimi i qumështit në vitet e fundit është rritur me 600 kg dhe në vitin e kaluar në 12.703 kg qumësht. Rendimentet e qumështit nga vitet 2003/2004 vijnë si pasojë e mjelies në tre kohë gjatë kësaj periudhe. Cilat janë arsyet?




Periudha e tharjes

Për një kohë të gjatë Hülsberg praktikon 1 fazë ne periudhen e tharjes. Në katër javët e fundit para pjelljes ushqimi i lopëve në tharje është identike me atë të mëshqerrave. Për profilaksinë e etheve përdoret prej shume vitesh Rind VK. E re prej dy vitesh është shtimi i 100 g Avital C Plus për kafshë në ditë gjatë periudhës së tharjes.



Në çfarë fazë do të prodhohen 600 kg më tepër e qumështit? Grafiku 2 tregon kthesën e laktacionin në tre viteve të fundit nga lopët me të paktën në pjellje të 2-të. Pas rreth 20 ditësh dallimet janë të dukshme: ato lopë që janë furnizuar me Rindavital C Plus ishin më të mirë në "periudhën e tranzicionit". Intensiteti i qumështit mbas 50 ditëshit të para ishte rreth 3 kg më e lartë. Ky ndryshim mbetet edhe gjatë laktacionit.


Ndryshe është situata e meshqerrave në laktacion te parë. Siç tregohet në grafikun nr. 3, prodhimi i qumështit deri në ditën 70 të laktacionit është pothuajse identik, dhe pastaj 3 kg qumësht më shumë në krahasim me rendimentin e rezultatin e vitit 2008. Në të dy vitet e kaluara prodhimi i 35 kg qumësht është arritur pak para ditës së 50-të të laktacionit dhe ka zbritur përsëri deri pas ditës së 200.



Mbas ditës së 300-të të laktacionit arrin të sjellë 5 kg më shumë qumësht. Sidomos në laktacionit e parë janë mjelur një shtesë prej 600 kg qumësht, të cilat për pjesën më të madhe janë vetëm në laktacionit 2 dhe 3. Pra, është në një fazë në të cilën është ekuilibruar bilanci energjetik ose më vonë edhe pozitiv.

Përqindja e ushqimeve voluminoze në lidhje me lëndën e thatë ishte në të gjitha tre vitet, më shumë se 60%. Sasia e ushqimit të koncentruar për kg qumësht po shkonte në rreth 274 g në një nivel në mënyrë uniforme të mirë. Efikasiteti i ushqimit (kg qumësht për kg marrje të lëndës së thatë), nuk ka ndryshuar në periudhën e shqyrtuar dhe arritur me 1.5 një vlerë të jashtëzakonshme (30 Litra qumesht /21 kg lëndë e thatë ushqim).

Studimet e mëhershme tregojnë në Hulsberg (grafiku 4) që efikasiteti në ushqim është edhe më vonë në laktacionit edhe për vlerën 1.4 është ende në një zonë shumë të favorshme. Nëse merret parasysh prodhimi i qumështit për çdo kg lëndë të thatë, pa kërkesë për mirëmbajtje, atëherë, për shembull, 1.9 kg qumësht për çdo kg lëndë të thatë mund të arrihet edhe në ditën e 300 të laktacionit.



Shpenzimet

Për një shtesë prej 600 kg qumësht kemi një rënie të kostove prej 12 € për lopë, gjatë përdorimit të Rindavital C Plus gjatë gjithë periudhës së tharjes. Duke qenë se, për këtë shtesë rendimenti nuk ka kërkesë të mirëmbajtjes së trupit, për çdo kg lëndë e thatë do të milen 2.15 kg qumësht.

Megjithatë, kjo këmbëngulje nuk vjen vetvetiu. Çdo rënie në prodhimin e qumështit, qoftë të shkaktuara nga shëndeti i dobët gjirit apo mungesa e cilësisë së foragjereve, do të thotë se edhe pas zgjidhjes së këtyre problemeve është shumë e vështirë të arrihen nivelet e vjetra të laktacionit.

Pavarësisht nga nivelet e larta të prodhimit dhe konsumin më të lartë të ushqimit, rritja e prodhimit për Hülsenberg është shumë fitimprurëse. Hülsenberg konfirmon: ia vlen rritja e performancës më shumë. Qëllimi është për të shfrytëzuar plotësisht potencialin ekzistues, jo vetëm të nivelit absolut të performancës, por sidomos, faktorë të tillë si cilësinë e ushqimit. Rritja e rendimentit nëpërmjet ushqimit voluminoz, ose jetëgjatesia duhet të përdoren për të përmirësuar performancën.